



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.684/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Përparim Shalës nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Gllogoc, të paraqitur kundër Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të dyshimit se u janë keqpërdorur votat, për Zgjedhjet lokale të datës 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa Anr.684/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Përparim Shala kandidat për Kuvend Komunal në Gllogoc nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, paraqitur kundër Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të dyshimit se u janë keqpërdorur votat në vendvotimet 0302e/01R; 0302e/02R; 0302e/03R; 0302e/04R dhe 0302e/05R në Gllogoc, për Zgjedhjet Lokale 2021, të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 18.10.2021, ka pranuar një ankesë Anr.684/2021 nga Përparim Shala kandidat për Kuvend Komunal në Gllogoc nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, në të cilën theksohet se në Qendrën e votimit në Komoran në Gllogoc nuk i kane ndalur votat nga qendrat e vendvotimit 0302e/01R; 0302e/02R; 0302e/03R; 0302e/04R dhe 0302e/05R. Parashtruesi i ankesës dyshon se u janë keqpërdorur votat nga personat përgjegjës ku për këtë thekson se ka dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë në vendvotimin me nr. 0302e/01R; 0302e/02R; 0302e/03R; 0302e/04R dhe 0302e/05R në Glllogoc, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së Përparim Shalës nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 684/2021 më datën 20.10.2021

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*

